

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit për Shoqata dhe Fondacione (Gazeta Zyrtare e RMV-së, Nr. 52/2010, 135/2011, 55/2016 dhe 239/2022), Asambleja e Asociacionit për Edukim PENDA AEP Tetovë (në tekstin e mëposhtëm: Asociacioni) nxori:

STATUTIN

e konsoliduar të Asociacionit për Edukim PENDA AEP Tetovë

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

(1) Me këtë statut rregullohen: emërtimi, selia dhe objektivat e Asociacionit; veprimtaritë me të cilat realizohen objektivat; mënyra e vendosjes për anëtarësimin, për përjashtimin dhe për pushimin e anëtarësimit në Asociacion; të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve; lloji i organeve dhe përbërja e tyre; mënyra e zgjedhjes dhe e shkarkimit; kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve në organe dhe mënyra e vendimmarrjes; përfaqësimi sipas ligjit; mënyra e krijimit dhe e posedimit të mjeteve; mënyra e miratimit të raporteve financiare dhe të raporteve të tjera; mënyra e realizimit të transparencës dhe të përgjegjësisë në punë; mënyra e nxjerrjes, e ndryshimit dhe e plotësimit të statutit; mënyra e vendosjes për ndryshimet statusore dhe për pushimin e Asociacionit; mënyra e nxjerrjes së plan-programeve; administrimi i mjeteve dhe i pasurisë në rast pushimi të Asociacionit; mënyra e nxjerrjes së akteve të përgjithshme dhe akteve të tjera; mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesit; si dhe mënyra e rregullimit të çështjeve të tjera të përcaktuara me ligj;

Neni 2

(1) Asociacioni është organizatë qytetare që ka për qëllim ta rrisë vetëdijen arsimore dhe kulturore në mbarë popullatën, lidhur me përparimin në lëminë e shkencës dhe të artit. Qëllimi i Asociacionit është angazhimi në veprimtari të ndryshme që kontribuojnë në përparimin e përvojës arsimore dhe në ngritjen kulturore. Asociacioni angazhohet për të investuar në fushën e arsimit dhe kulturës. Asociacioni ka theks të veçantë në gjetjen dhe grumbullimin e fondeve për ta përmirësuar ngritjen arsimore dhe kulturore, sidomos të studentëve të talentuar që janë me perspektivë, por që nuk kanë mundësi për t'i realizuar qëllimet e veta akademike, shkencore dhe kulturore. Asociacioni do t'u ndihmojë të tjerëve për t'u bërë qytetarë më të devotshëm nëpërmjet ngritjes arsimore dhe kulturore. Asociacioni ka për qëllim avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe qasjen e lirë dhe gjithëpërfshirëse të të gjithë qytetarëve në arsim, shkencë dhe kulturë.

Neni 3

- (1) Themeluesit e Asociacionit të drejtat dhe përgjegjësitë e veta i përmbushin me aktin e themelimit të Asociacionit.
- (2) Me statut dhe me akte të përgjithshme dhe të veçanta, nuk mund të përcaktohen të drejta dhe përgjegjësi të posaçme të themeluesve të Asociacionit.
- (3) Themeluesit regjistrohen si pronarë të Asociacionit në regjistrin qendror të shoqatave dhe të fondacioneve derisa ata janë anëtarë të Asociacionit.
- (4) Nëse themeluesit ndërrojnë nënshtetësinë e tyre, ato duhet ta lajmërojnë Asociacionin para se të ndërrojnë nënshtetësinë që të shlyhen nga lista e pronarëve të Asociacionit në regjistrin qendror të shoqatave dhe fondacioneve.
- (5) Anëtarët e tjerë që nuk janë themelues mund të regjistrohen si pronarë të Asociacionit në regjistrin qendror për shoqata dhe fondacione, përderisa për këtë ka vendosur Asociacioni nëpërmjet proceseve të vendimmarrjes në përputhje me dispozitat e këtij statuti.

Neni 4

- (1) Asociacioni është themeluar për kohë të pacaktuar.

II. EMËRTIMI DHE SELIA

Neni 5

- (1) Emërtimi i Asociacionit në gjuhën shqipe është: Asociacioni për Edukim PENDA AEP Tetovë.
- (2) Emërtimi i shkurtër i Asociacionit në gjuhën shqipe është: PENDA AEP Tetovë.
- (3) Emërtimi i Asociacionit në gjuhën maqedonase është: Асоцијација за Едукација ПЕНДА АЕП Тетово.
- (4) Emërtimi i shkurtër i Asociacionit në gjuhën maqedonase është: ПЕНДА АЕП Тетово.

- (5) Motoja e Asociacionit në gjuhën shqipe është: Emancipim, Dituri, Urtësi.
- (6) Motoja e Asociacionit në gjuhën maqedonase është: Еманципација, Знаење, Мудрост.

Neni 6

(1) Selia e Asociacionit ndodhet në Tetovë, rr. "Ivo Lola Ribar", nr. 8. Vendimin e vendndodhjes së selisë e merr Asambleja.

Neni 7

- (1) Asociacioni e ka vulën e vet si dhe vulën katrore.
- (2) Vula e Asociacionit është në formë të rrumbullakët dhe në të është shkruar teksti në gjuhën shqipe: Asociacioni për Edukim PENDA АЕР Tetovë dhe teksti në gjuhën maqedonase me alfabet cirilik: Асоцијација за Едукација ПЕНДА АЕП Тетово.
- (3) Vula katrore e Asociacionit është në formë të drejtkëndeshit dhe në të është shkruar teksti: Asociacioni për Edukim PENDA АЕР Tetovë, Асоцијација за Едукација ПЕНДА АЕП Тетово. Në të figuron vendi i numrit të protokollit, data dhe shtojca.
- (4) Përdorimin e vulës dhe të vulës katrore të Asociacionit e përcakton Bordi.

III. OBJEKTIVAT

Neni 8

- (1) Objektivi themelor i Asociacionit është investimi në zhvillimin dhe ngritjen e arsimit, shkencës dhe kulturës së qytetarëve, veçanërisht të studentëve të talentuar që kanë perspektivë, si dhe ndërtimi i qëllimeve të tyre personale, profesionale dhe akademike.
- (2) Objektivat tjera të Asociacionit do të jenë: përfaqësimi dhe lobimi i legjislativës, ngritja e vetëdijes publike dhe ndikimi i diskursit intelektual me qëllim që të lehtësohet mjedisi publik për avancimin e objektivës themelore të Asociacionit.

Neni 9

- (1) Objektivat afatgjate të Asociacionit janë:
- (a) të sigurojë bursa për studentët e suksesshëm dhe të talentuar, të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta vazhduar arsimimin e tyre;
 - (b) të ofrojë këshilla dhe mentorim për studentët e suksesshëm dhe të talentuar, të cilët kanë nevojë për bursa për ngritjen e tyre profesionale;
 - (c) të ndjekë përparimin e studentëve, të cilët marrin bursa prej Asociacionit dhe të vlerësojë nëse është e arsyeshme të vazhdojë të japë bursa për të njëjtit;
 - (d) të organizojë ngjarje të ndryshme sociale me qëllim të rritjes së interesit publik në lëminë e shkencës, artit dhe kulturës;
 - (e) të kërkojë donacione nga organizatat ose institucionet e vendit dhe të huaja për të siguruar mjete pune; si dhe
 - (f) të grumbullojë buxhetin operativ minimal nga anëtarët e vet.
- (2) Objektivat tjera të Asociacionit janë:
- (a) rritja e numrit të anëtarëve, duke tërhequr persona me ide të ngjashme, të cilët janë të interesuar për përparimin e objektivave të këtij Asociacioni;
 - (b) paraqitjet në medime për ngritjen e nivelit të afirmimit të Asociacionit;
 - (c) ndihmë studentëve për përparimin e karrierës së tyre akademike, duke mbështetur vizita në kampet verore, në konferenca, nëpër institucionet akademike në vendin tonë por edhe jashtë vendit;
 - (d) krijimi i mjedisit motivues intelektual në të cilin studentët do të mund t'i këmbëjnë përvojat e veta dhe t'i ndihmojnë njëri-tjetrit për arritjen e synimeve të tyre arsimore;
 - (e) të bashkëpunojë, të lidhet dhe të anëtarësohet në organizata të tjera të vendit dhe në ato ndërkombëtare, të cilat punojnë në çështje të njëjta apo të ngjashme;
 - (f) të sigurojë kushte materiale, financiare dhe juridike për punën e Asociacionit dhe të anëtarëve të saj;

Neni 10

(1) Asociacioni është në shërbim të qytetarëve pa dallim përkatësie kombëtare, religjioze apo përkatësie dhe përcaktimi tjetër.

Neni 11

(1) Parimet mbi të cilat mbështetet puna e Asociacionit janë: *pavarësia, karakteri publik i punës dhe transparenca, mospërfitimi, veprimi jopartiak, nismat në jetën publike, participimi (pjesëmarrja), partneriteti, toleranca, ndërmarrësia, qëndrueshmëria dhe mundësitë e barabarta.*

Neni 12

- (1) Asociacioni vepron në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (2) Asociacioni vepron edhe në nivel ndërkombëtar, në përputhje me politikën dhe me strategjinë e vet të përgjithshme.

IV. ANËTARËSIMI

Neni 13

- (1) Anëtar i Asociacionit mund të jetë çdo qytetar, i cili aderohet në mënyrë vullnetare dhe i pranohet objektivat e Asociacionit, të përcaktuar me këtë statut. Anëtarësimi inicohet me nominimin e kandidatit, të paktën prej dy anëtarëve aktual të Bordit. Pas emërimit, pranimin e anëtarit të ri e miraton Bordi.
- (2) Anëtarësimi i të nominuarit bëhet me shkrim nga ana e kandidatit dhe i drejtohet Asociacionit për shqyrtim.
- (3) Asociacioni detyrohet t'i përgjigjet me shkrim kërkesës së kandidatit.
- (4) Formën dhe përmbajtjen e të dhënave që duhet të dorëzohen nga anëtarët e ri gjatë anëtarësimit e cakton Bordi.
- (5) Anëtarët e ri detyrohen të dërgojnë një dokument identifikues (letërnjoftim apo pasaportë) me qëllim që të verifikohet identiteti i anëtarëve të ri.

Neni 14

- (1) Asociacioni mban regjistër anëtarësh.
- (2) Të dhënat në regjistër përditësohen të paktën një herë në dy vjet dhe mbrohen në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të informatave të klasifikuara.
- (3) Asociacioni e garanton anonimitetin e të dhënave personale në regjistrin e anëtarëve, të cilët kërkojnë një gjë të tillë.
- (4) Anëtarët detyrohen të informojnë Asociacionin dhe të përditësojnë të dhënat e tyre personale kur dokumentet që verifikojnë identitetin e tyre ndryshojnë apo skadojnë.

Neni 15

- (1) Çdo anëtar i Asociacionit ka të drejta dhe përgjegjësi në përputhje me dispozitat e këtij statuti dhe të akteve të tjera të Asociacionit.
- (2) Çdo anëtar ka të drejtë të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur në organet dhe në forumet e Asociacionit, si dhe të përfaqësohet në të gjitha veprimtaritë e Asociacionit.
- (3) Çdo anëtar i Asociacionit paguan anëtarësi vjetore.
- (4) Vendimin për sasinë dhe për mënyrën e pagesës së anëtarësisë e merr Bordi.

Neni 16

- (1) Anëtarësia në Asociacion pushon duke dalë vullnetarisht prej saj, ose duke u përjashtuar prej saj.
- (2) Çdo anëtar mund të dalë nga Asociacioni vullnetarisht duke nënshkruar deklaratë me shkrim, e cila i drejtohet Asociacionit.
- (3) Anëtarësia pushon nëpërmjet përjashtimit, në rastet kur anëtari:
 - (a) nuk e respekton statutin dhe aktet e tjera të Asociacionit;
 - (b) vepron në kundërshti me objektivat e Asociacionit;
 - (c) nuk e paguan anëtarësinë vjetore dy herë radhazi;
 - (d) nuk merr pjesë në asnjë mbledhje ose organizim të Asociacionit gjatë vitit.
- (4) Anëtarësia mund të merret nga Asambleja me dy të tretat e votave të përgjithshme. Anëtarësia mundet të merret edhe nga Bordi me dy të tretat e votave të përgjithshme të Bordit. Gjatë vendim-marrjes për përjashtim supozohet se të gjithë anëtarët e trupit përkatës janë prezent.
- (5) Me rastin e pushimit të anëtarësisë në Asociacion, Asociacioni i drejtohet me shkrim anëtarit, të cilit i pushon anëtarësimi me shënimin se anëtari është larguar vetë, përkatësisht është përjashtuar nga Asociacioni.

Neni 17

(1) Personi, i cili e humb anëtarësinë në Asociacion, njëherazi i humb edhe të gjitha pozicionet e tjera që ekzistojnë në kuadër të Asociacionit. Këto pozicione hapen për plotësim në bazë të procedurave të rregullta.

V. ORGANET E ASOCIACIONIT

Neni 18

- (1) Organe të Asociacionit janë: Asambleja, Bordi, Bordi mbikqyrës, Kryetari dhe Nënkyetari.
- (2) Organet e Asociacionit zgjidhen sipas mënyrës së përcaktuar me këtë statut. Kandidatët për anëtarë të organeve të Asociacionit duhet të jenë persona me integritet, me kompetencë dhe të afirmuar.
- (3) Anëtarët e organeve të Asociacionit veprojnë me kapacitetin personal dhe marrin vendime sipas bindjeve të veta.
- (4) Anëtarët që kanë lidhje familjare të brezit të parë, përpos Asamblesë, nuk mund të veprojnë në organin e njëjtë të Asociacionit.

1. Asambleja

Neni 19

- (1) Asambleja e Asociacionit është organi më i lartë i Asociacionit dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e Asociacionit.
- (2) Asambleja:
 - (a) nxjerr statutin, programin dhe aktet e tjera të Asociacionit;
 - (b) miraton raportin vjetor të punës dhe raportin financiar dhe e shpall atë në faqen e uebit të Asociacionit;
 - (c) ia dërgon raportin financiar organit kompetent të administratës shtetërore, organit të komunave, në rastet kur shfrytëzon mjete nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale;
 - (d) vendos për ndryshimin e objektivit të Asociacionit;
 - (e) vendos për organizimin e brendshëm dhe për format organizative të organeve të Asociacionit;
 - (f) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin, Nënkyetarin dhe anëtarët e Bordit;
 - (g) vendos për ndryshimet e statutit të Asociacionit;
 - (h) vendos për anëtarësimin dhe për daljen nga Asociacionet dhe nga organizatat ndërkombëtare;
 - (i) vendos për pushimin e Asociacionit me shumicën e dy të tretës së votave të të gjithë anëtarëve të Asociacionit; dhe
 - (j) ushtron edhe punë të tjera, në përputhje me statutin dhe me aktet e Asociacionit.

Neni 20

- (1) Asambleja punon në seanca.
- (2) Asambleja mban seancë (mbledhje) të paktën një herë në vit, por edhe sipas nevojës.
- (3) Seancat e Asamblesë i thirr Kryetari, me nismën e vet, me kërkesën e Bordit apo me kërkesën e 10 anëtarëve të Asamblesë. Po qe se Kryetari brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së propozimit nuk thirr seancë, atëherë seancën e thirr Bordi apo nismëtarët.
- (4) Asambleja nxjerr rregullore pune me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Neni 21

- (1) Kryesuesi i seancës së Asamblesë është Kryetari. Kur seancën e asamblesë e thirr Bordi, kryesues është një anëtar i Bordit por jo Kryetari apo Nënkyetari. Nëse seancën e asamblesë e thërret Asambleja, kryesues zgjidhet një anëtar i Asamblesë por jo Kryetari, Nënkyetari apo ndonjë anëtar i Bordit.
- (2) Kryesuesi i Asamblesë zgjidhet në fillim të seancës për çdo seancë të veçantë varrësisht si është bërë thirrja për seancën e Asamblesë.
- (3) Kryesuesi i Asamblesë përcakton rendin e ditës dhe i lajmëron të gjithë anëtarët për këtë paraprakisht.

Neni 22

- (1) Asambleja ka të drejtë të vendosë po qe se në seancë marrin pjesë shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.
- (2) Asambleja vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, por jo më pak se një të tretën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve, po qe se me këtë statut nuk parashikohet shumicë e veçantë.
- (3) Asambleja vendos me votim të hapur për të gjitha çështjet.
- (4) Asambleja vendos me votim të fshehtë vetëm për zgjedhjen dhe shkarkimin e Kryetarit, të Nënkyetarit dhe të anëtarëve të Bordit.
- (5) Anëtarët mund të marrin pjesë në votim edhe nëpërmjet telekonferencës.
- (6) Asambleja mund të vendos edhe nëpërmjet listës zyrtare elektronike postare të Asociacionit. Kur votimi bëhet në këtë mënyrë, supozohet se të gjithë anëtarët janë prezent në mbledhje.

Neni 23

- (1) Për punën e Asamblesë mbahet procesverbal që i përmban të dhënat e përcaktuara me rregulloren e punës.
- (2) Procesverbalin e mban mbajtësi i procesverbalit dhe verifikohet nga kryesuesi i Asamblesë si dhe nga Kryetari.

2. Përfaqësuesi

Neni 24

- (1) Përfaqësuesi i Asociacionit zgjidhet nga Bordi dhe aprovohet nga kryetari.
- (2) Përfaqësuesi duhet të jetë anëtar i Bordit dhe duhet të jetoj dhe të veprojë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- (3) Përfaqësuesi nuk mund të vendos vetë me palët tjera, por vetëm përfaqëson vendimet dhe politikat e Asociacionit që janë marrë nga organet e saja të parapara me këtë statut dhe në pajtim me ligjin.
- (4) Në rast të dënimit që i shqiptohet Përfaqësuesit nga autoritetet shtetërore, Përfaqësuesi kompensohet në mënyrë të barabartë nga të gjithë anëtarët e Asociacionit që kanë marrë pjesë në vendimin për të cilën shqiptohet Përfaqësuesi. Anëtarët që kanë votuar kundër ose të përmbajtur nuk detyrohen të kompenzojnë Përfaqësuesin.

3. Kryetari

Neni 25

- (1) Kryetari:
 - (a) e përfaqëson Asociacionin në qarkullimin juridik me persona të tretë dhe është përgjegjës për komunikim dhe për bashkëpunim me persona të tjerë;
 - (b) përcjell dhe analizon gjendjen, problemet dhe politikat publike në veprimtarinë e Asociacionit, jep prognoza dhe parashikime, ndërmerr nisma dhe jep propozime për përparimin e punës;
 - (c) kujdeset (identifikon, zhvillon dhe zbaton) për planifikimin strategjik dhe i përgatit programet perspektive, vjetore dhe periodike si dhe planet afariste (me planet financiare) dhe është përgjegjës për realizimin e tyre;
 - (d) i paraqet raporte periodike Bordit si dhe raporte vjetore – Asamblesë;
 - (e) e udhëheq organizatën dhe e zhvillon kulturën organizative;
 - (f) vendos procedura përkatëse për punën e Asociacionit;
 - (g) formon komisione dhe grupe pune;
 - (h) kujdeset për administrimin e drejtë dhe ekonomik të mjeteve të Asociacionit si dhe e administron rrjedhën e parave;
 - (i) vendos për krijimin e marrëdhënies së punës dhe i udhëheq dhe i motivon bashkëpunëtorët;
 - (j) i përcakton treguesit dhe i vlerëson arritjet në punë;
 - (k) përgatit raporte, analiza, informata dhe materiale të tjera për nevojat e organeve të Asociacionit;
 - (l) mund të përgatit propozim-vendime dhe propozim-akte për miratim nga organet e Asociacionit;
 - (m) kryen blerjen e materialit për konsumim për nevojat e Asociacionit, dhe
 - (n) kryen punë të tjera, në përputhje me këtë statut dhe me aktet e përgjithshme të Asociacionit.
- (2) Kryetari është përgjegjës:
 - (a) për ligjshmërinë, rregullsinë dhe kryerjen në kohë të punëve të Asociacionit si dhe për sigurimin e

- kushteve të punës, në përputhje me ligjet, me statutin dhe me aktet e përgjithshme të Asociacionit;
- (b) për përgatitjen dhe për prezantimin në kohë, objektiv dhe të saktë të raporteve financiare;
 - (c) për administrimin dhe për përcjelljen e rreziqeve, të cilave u ekspozohet Asociacioni.

(3) Kryetari, në kuadër të të drejtave dhe të autorizimeve të veta, mund t'i japë ndonjë personi tjetër autorizim me shkrim, për të ndërmarrë veprime të caktuara juridike, si dhe për ta përfaqësuar para organeve të jurisprudencës dhe organeve të tjera. Përmbajtjen, llojin, vëllimin dhe kohëzgjatjen e autorizimit e përcakton Kryetari.

(4) Punët profesionale dhe ato tekniko-administrative për nevojat e Asociacionit i kryen Kryetari i Asociacionit.

Neni 26

(1) Kryetari e ka të drejtën e urdhrit ekzekutiv. Urdhrat ekzekutive duhet të shfrytëzohen rrallë dhe në raste të veçanta.

(2) Urdhri ekzekutiv hyn në fuqi po që se nuk mbivotohet nga Bordi apo nga gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Asamblesë.

(3) Urdhri ekzekutiv duhet të jetë publik për të gjithë anëtarët e Asociacionit dhe të shpallet në listën zyrtare elektronike postare të Asociacionit.

(4) Po që se ndaj urdhrit ekzekutiv nuk vihet veto brenda një periudhë prej një muaji, me këtë rast ai hyn në fuqi.

(5) Kryetari mund ta ndryshojë statutin e Asociacionit nëpërmjet urdhrit ekzekutiv.

Neni 27

(1) Kryetari dhe Nënkyetari zgjidhen nga anëtarët e Asamblesë.

(2) Votimi bazohet në mekanizmin e Votës së Vetme të Transferueshme (Single Transferable Vote ose STV). Anëtarët mund të emërojnë çfarëdo numri të anëtarëve, duke përfshirë edhe vetë ata. Me rastin e votimit, anëtarët do t'i rangojnë preferencat e tyre.

(3) Pozitat e Kryetarit dhe Nënkyetarit do t'u ofrohen anëtarëve sipas rangimit STV. Me rastin e votimit të Kryetarit dhe të Nënkyetarit në kuadër të sistemit të njëjtë STV, Kryetari, në krahasim me Nënkyetarin, duhet të jetë në rang më të lartë.

(4) Kryetari dhe Nënkyetari janë persona, të drejtat, autorizimet dhe përgjegjësitë e të cilëve ndërlidhen me udhëheqjen e Asociacionit si dhe me përfaqësimin e Asociacionit, në përputhje me ligjin dhe me këtë statut.

(5) Mandati i Kryetarit dhe i Nënkyetarit zgjat katër vjet dhe është i kufizuar jo më shumë se në dy mandate.

(6) Kryetari dhe Nënkyetari janë anëtarë të Bordit dhe në të njëjtën kohë kryetar dhe nënkyetar të Bordit.

Neni 28

(1) Në mungesë të Kryetarit, rolin e tij e merr Nënkyetari.

Neni 29

(1) Kryetari ose Nënkyetari mund të përjashtohen prej pozitave të tyre me dy të tretat e votave të përgjithshme të Bordit.

4. Bordi

Neni 30

(1) Bordi është organ i Asociacionit, punët e të cilit janë të ndërlidhura me administrimin e përgjithshëm dhe me përcjelljen e veprimtarisë së përditshme të Asociacionit.

(2) Bordi përbëhet prej dymbëdhjetë anëtarëve.

(3) Mandati i anëtarëve të Bordit zgjat katër vjet, me të drejtën e rizgjedhjes.

(4) Anëtarët e Bordit nuk kanë përkufizim në numrin se sa herë mund të rizgjidhen.

Neni 31

(1) Bordi:

- (a) nxjerr aktet e përgjithshme të Asociacionit si dhe e përcjell zbatimin e statudit;

- (b) ndryshon dhe plotëson statutin;
- (c) e propozon programin vjetor të veprimtarisë së Asociacionit dhe e përcjell zbatimin e programit;
- (d) merr vendime për shpërblimet, për lëvdatat dhe për mirënjohjet;
- (e) merr vendime për blerjen dhe për tjetërsimin e mjeteve themelore;
- (f) udhëheq mirë dhe kujdeset për pasurinë dhe për mjetet e Asociacionit;
- (g) propozon revizor të pavarur (shoqëri për revizion);
- (h) e miraton llogarinë përfundimtare;
- (i) i përgatit dhe i zbaton vendimet e Asamblesë;
- (j) ushtron punë të tjera, në përputhje me këtë statut dhe me aktet e përgjithshme të Asociacionit.

Neni 32

- (1) Bordi punon dhe vendos në seanca.
- (2) Bordi mban të paktën dy mbledhje në vit.
- (3) Kryetari udhëheq me mbledhjet e Bordit.
- (4) Mbledhjet e Bordit i thirr Kryetari i Bordit me nismën e vet ose me kërkesën e tre anëtarëve të Bordit.
- (5) Kryetari ka për detyrë të thirr mbledhje brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.
- (6) Thirrja e mbledhjes bëhet me ftesë në të cilën theksohet koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes si dhe propozimi i rendit të ditës.
- (7) Për punën e seancës (mbledhjes) mbahet procesverbal, të cilin e verifikon Kryetari dhe një anëtar i Bordit.
- (8) Bordi vendos me shumicën e votave të anëtarëve prezent, po jo më pak se një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit.

Neni 33

- (1) Anëtarët e Bordit zgjidhen nga anëtarët e Asamblesë, nëpërmjet mekanizmit të votës së vetme të transferueshme (Single Transferable Vote - STV).
- (2) Anëtarët e Asamblesë mund të emërojnë çfarëdo numri anëtarësh, duke përfshirë edhe veten, të cilët do t'i radhitin sipas rangimit.
- (3) Vendet e zbrazëta të Bordit do të plotësohen sipas rangimit paraprak të siguruar me votimin STV.
- (4) Po që se me votimin paraprak STV nuk plotësohet numri i duhur i vendeve, për vendet që kanë mbetur të paplotësuara do të zbatohet votim i ri STV, deri në plotësimin e plotë të tyre.

Neni 34

- (1) Anëtari i Bordit mund të shkarkohet nga pozita e tij, po që se për një gjë të tillë votojnë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit.

5. Bordi mbikqyrës

Neni 35

- (1) Bordi mbikqyrës është organ i Asociacionit, punët e të cilit janë të ndërlidhura me kontrollin e veprimtarisë së Asociacionit dhe të organeve të saj.
- (2) Bordi mbikqyrës përbëhet prej pesë anëtarëve.
- (3) Mandati i anëtarëve të Bordit mbikqyrës zgjat katër vite, me të drejtën e rizgjedhjes.
- (4) Anëtarët e Bordit mbikqyrës nuk kanë kufizim në numrin e mandateve që mund të rizgjidhen.
- (5) Anëtarët e Bordit mbikqyrës nuk kanë të drejtë të jenë anëtarë në organet tjera drejtuese të Asociacionit derisa e kryejnë funksionin e anëtarit të këtij trupi.
- (6) Bordi mbikqyrës:
 - (a) zgjedh kryesues, i cili udhëheq me mbledhjet e Bordit mbikqyrës;
 - (b) kryen kontrollë të veprimtarisë materiale dhe financiare të Asociacionit;
 - (c) shqyrton programin vjetor për punë dhe zhvillim dhe planin vjetor financiar të Asociacionit dhe jep mendim për të njëjtën Asamblesë;
 - (d) kryen kontroll mbi punën e Asociacionit, Bordit, Kryetarit dhe Nënkryetarit, në përputhje me ligjin, statutin dhe aktet e tjera të Asociacionit;

- (e) propozon masa që duhet të ndërmerren për të eliminuar parregullsitë dhe paligjshmëritë në punën e Asociacionit;
- (f) ushtron punë të tjera, në përputhje me këtë statut dhe me aktet e përgjithshme të Asociacionit;

Neni 36

- (1) Bordi mbikqyrës punon dhe vendos në seanca.
- (2) Bordi mbikqyrës mban të paktën një mbledhje çdo gjashtë muaj.
- (3) Mbledhjet e Bordit mbikqyrës i thirr kryesuesi i Bordit mbikqyrës me nismën e vet, me kërkesën e më së paku tre anëtarëve të Bordit mbikqyrës.
- (4) Kryesuesi i Bordit mbikqyrës ka për detyrë të thirr mbledhje brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.
- (5) Thirrja e mbledhjes bëhet me ftesë në të cilën theksohet koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes si dhe propozimi i rendit të ditës.
- (6) Për punën e seancës mbahet procesverbal, të cilin e verifikon kryesuesi dhe një anëtar i Bordit mbikqyrës.
- (7) Procesverbali i Bordit mbikqyrës shpallet në kanalet e komunikimit të Asociacionit.
- (8) Bordi mbikqyrës vendos me shumicë të votave të anëtarëve të përgjithshëm.

Neni 37

- (1) Anëtarët e Bordit mbikqyrës zgjidhen po nga e njëjta zgjedhje sikurse ajo e Bordit dhe të organeve të tjera, pra nga anëtarët e Asamblesë, nëpërmjet mekanizmit të votës së vetme të transferueshme (Single Transferable Vote - STV).
- (2) Vendet e zbrazëta të Bordit mbikqyrës plotësohen sipas rangimit paraprak të siguruar me votimin STV.
- (3) Anëtari i Bordit mbikqyrës mund të shkarkohet nga pozita e tij, po që se për një gjë të tillë votojnë më shumë se dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit mbikqyrës.

VI. VEPRIMTARIA FINANCIARE DHE AFARISTE

Neni 38

- (1) Asociacioni mjetet për financim i krijon nga anëtarësimi, nga depozitat e themelimit, nga kontributet vullnetare, nga donacionet, nga dhuratat (në para, në të mira, të drejta pronësore), nga pasuritë e lëna me testament, nga legatat (gjëra të lëna me testament), nga veprimtaritë fitimprurëse, nga qiratë dhe qiramarrjet, si dhe nga të hyrat prej investimeve, dividendave, kamatave, huave si dhe nga të hyra të tjera, në përputhje me ligjin dhe me statutin.

Neni 39

- (1) Mjetet financiare të Asociacionit përdoren për realizimin e objektivave të Asociacionit, të përcaktuar me këtë statut dhe me programin e Asociacionit si dhe në përputhje me rregullat dhe me kufizimet e burimeve të financimit.
- (2) Teprica e të hyrave të realizuara mbi shpenzimet (fitimi), duhet të përdoret për realizimin e objektivave të Asociacionit, të përcaktuara me këtë statut dhe nuk mund të ndahet midis themeluesve, anëtarëve, anëtarëve të organeve, Kryetarit, Nënkyetarit, Përfaqësuesit, të punësuarëve apo cilitdo person tjetër, të ndërlidhur me ta.

Neni 40

- (1) Viti financiar përputhet me vitin kalendarik.
- (2) Masa dhe mënyra e shpërndarjes së mjeteve të Asociacionit përcaktohet çdo vit me planin financiar, në bazë të planit vjetor afarist.
- (3) Planin vjetor afarist, duke përfshirë edhe planin financiar, e miraton Bordi.
- (4) Plani vjetor afarist miratohet në fund të vitit kalendarik në vazhdim, për vitin e ardhshëm.
- (5) Po që se plani vjetor afarist nuk miratohet brenda afatit të parashikuar me paragrafin 4 të këtij neni, financimi do të kryhet në masën e mjeteve nga viti paraprak, të shtuara me ngritjen e çmimeve me pakicë në vitin në vazhdim.

Neni 41

- (1) Asociacioni mban kontabilitet, mban dhe ruan regjistra, paraqet llogari vjetore dhe kryen regjistrim

sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

- (2) Bordi e rregullon me akt të përgjithshëm veprimtarinë financiare.
- (3) Raportin e regjistrimit e miraton Bordi.

Neni 42

- (1) Asociacioni ka raport vjetor, llogari vjetore dhe raporte financiare në përputhje me ligjin, me këtë statut dhe me aktet e përgjithshme të Asociacionit.
- (2) Raporti vjetor përbëhet nga raporti për arritjet dhe nga raporti financiar. Përmbajtja e raportit vjetor dhe e raportit financiar është në përputhje me ligjin si dhe me standardet e raportimit financiar.
- (3) Përgjegjës për raportin vjetor, për llogarinë vjetore dhe për raportet financiare, përkatësisht për përgatitjen dhe për nënshkrimin e tyre është Kryetari.
- (4) Po që se buxheti vjetor i Asociacionit është mbi 20,000.00 euro në kundërvlerën në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Asambleja mund të vendosë të kryejë revizion vjetor të pavarur të veprimtarisë financiare, e po që se buxheti është mbi 100,000.00 euro në kundërvlerën në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Asociacioni detyrohet të kryejë revizion të pavarur në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.
- (5) Raportin vjetor dhe raportin financiar për vitin paraprak, e miraton Asambleja deri më 30 mars të vitit kalendarik në vazhdim, përkatësisht brenda afatit të caktuar me ligj. Raporti vjetor dhe raporti financiar për vitin paraprak publikohen në faqen e uebit të Asociacionit, jo më vonë se 30 prill të vitit kalendarik në vazhdim.

VII. MBROJTJA E INTERESAVE

Neni 43

- (1) Kryetari dhe anëtarët e organeve të Asociacionit kanë për detyrë të administrojnë dhe të punojnë me vëmendje dhe në përputhje me parimet e administrimit të mirë, në interes të Asociacionit dhe jashtë interesave personale, përkatësisht në interes të realizimit të objektivave, në përputhje me ligjin dhe me këtë statut.

Neni 44

- (1) Asociacioni përgjigjet për detyrimet e veta me tërë pasurinë e vet dhe me të gjitha mjetet e veta.
- (2) Çdo anëtar i Asociacionit përgjigjet personalisht dhe në mënyrë të pakufizuar për detyrimet e tyre ndaj Asociacionit për shpërdorimin e mjeteve të Asociacionit për të realizuar qëllime, të cilat për ta si individë, janë të ndaluara, apo për keqpërdorimin e Asociacionit, si person juridik, duke u shkaktuar dëm kreditorëve të vet.

Neni 45

- (1) Anëtarët e Asociacionit janë përgjegjës në mënyrë solidare për dëmin që i është shkaktuar Asociacionit nga puna e tyre, po që se dëmi është shkaktuar nga një pakujdesi e patolerueshme apo në mënyrë të qëllimshme, përveç kur me rastin e vendosjes nuk janë pajtuar me vendimin, gjë që e kanë shprehur në procesverbal apo në qoftë se nuk kanë marrë pjesë në marrjen e vendimit.

VIII. KONFLIKT INTERESI

Neni 46

- (1) Në rast të konfliktit të interesit, çdo anëtarë është i detyruar të raportojë për konfliktin e interesit para se të vendoset për vendimin që shfaq konflikt interesi për anëtarët në fjalë.
- (2) Gjatë konfliktit të interesit, votat e anëtarëve që kanë konflikt interesi nuk mirren parasysh. Nëse anëtarët që kanë konflikt interesi janë prezent në senancat e Asociacionit, prezenca e tyre mirret parasysh për të vendosur nëse ka kuorum për vendimmarrje.

IX. PUSHIMI I SHOQATËS

Neni 47

- (1) Asociacioni pushon të ekzistojë po që se:
 - (a) numri i anëtarëve të Asociacionit bie nën numrin e caktuar për themelim;
 - (b) afati i parashikuar i mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë është tejkaluar dyfish dhe mbledhja nuk

është mbajtur;

- (c) dy vite radhazi nuk është paraqitur llogari përfundimtare, në përputhje me ligjin;
- (d) në rast ndryshimi të statutit me të cilin parashikohet pushimi i ekzistimit;
- (e) është marrë vendim nga gjykata kompetente;
- (f) në rast falimentimi, ose
- (g) në rast zbatimi të likuidimit.

Neni 48

(1) Në rast pushimi të Asociacionit, pasurinë dhe mjetet që mbeten pas shlyerjes së detyrimeve, do t'i ketë në dispozicion Komuna e Tetovës. Komuna e Tetovës do t'i shfrytëzojë fondet e Asociacionit për të blerë libra për nevojat e bibliotekës së qytetit të Tetovës.

X. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 49

(1) Interpretimin e dispozitave të këtij statuti e bën Asambleja, ndërsa ndërmjet dy seancave të Asamblesë, Bordi.

Neni 50

(1) Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti kryhen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë siç ka qenë mënyra dhe procedura e miratimit të tij.

Neni 51

(1) Ky statut hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hapësirat e Asociacionit.

Vendi dhe data:

Tetovë, më 15.04.2023

Asociacioni për Edukim PENDA AEP Tetovë

Përfaqësues:

Mentar Mahmudi